


TIRANE 2021

POROSITI :



BashkiaShkoder

# RELACION TEKNIK

## Punimeve ndertimore

**OBJEKTI**

RIKONSTRUKSION SHKOLLA AZEM HAJDARI

LENI-ING SH.P.K

## RELACION TEKNIK SHKOLLA AZEM HAJDARI SHKODER

Forma, dimensionet, elementet konstruktive, orientimi i ndërtesës dhe gjithçka tjetër nevojitet për realizimin e projektit janë marre nga vizatimet e rievimit të ofruara nga specialistet e Bashkisë.

### **Te dhëna për projektin, kriteret e dimensionimit, zgjedhjet**

Objekti ndodhet brenda në qytetin e Shkodrës dhe është ndërtuar në vitet 80. Gjate viteve planimetria nuk ka pësuar ndryshime. Ka katër kate mbi tokë të njëjta për nga dimensionet. Ka një sipërfaqe bruto në plan (gjurmë) prej 530 m<sup>2</sup>.

Ndërtesa nuk ruan vlera të veçanta historike për qytetin.

Pas ndërhyrjeve të fazës së më përparshme si rikonstruksioni i pjesës së terracës është përfunduar. Në këtë fazë do bëhet instalimi i rrjetit të sistemit të ngrohjes pa central termik, rrjeti elektrik tërësisht i ri, përfshi sinjalistikë për MNZ, si dhe punime ndërtimore.

### **Përshkrimi i punimeve që do të kryhen**

#### Suvatimet

Do bëhen vetëm kepe të suvatimeve dhe riparime aty ku do konsiderohet e nevojshme, nuk është parashikuar prishja e shtresave të suvasë deri në tulle. Dhe pastaj do procedohet me shtresën e fundit të finos për gjithë sipërfaqen e suvasë në të gjithë objektin, mure dhe solete.

#### Pllakat

Pas prishjes së shtresës së pllakave dhe shtresës së vjetër niveluese të betonit, do bëhet shtresa e re nivelues me stirobeton për të ulur peshën dhe për të rritur efikasitetin energjetik. Pllakat do të jenë porcelani, të cilat pas dërgimit të mostrave do përzgjidhen nga Autoriteti Kontraktor. Kontraktuesi pa miratimin e materialit nuk do procedojë me vendosjen e pllakave.

#### Bojatisja

Ngjyrat e bojatisjes do përcaktohen nga Autoriteti Kontraktor. Boja që do përdoret do miratohet me përpara nga Autoriteti Kontraktor për cilësinë e saj pastaj do zgjidhet

ngjyra. Autoriteti Kontraktor i lejon vetes te drejtën e zgjedhjes te çfarëdo pigmenti apo lloji ngjyre sipas standardit përkatës për boje hidromat.

#### Tualeti

Do behet rikonstruksioni i tualeteve ekzistuese te katit përdhe, pa prishur muret. Do behet prishja pllakave dhe **heqja e lavamanëve pa i dëmtuare ato** dhe dorëzimi i tyre tek AK me procesverbal. Do ribëhet tërësisht shtrimi i tubacioneve te reja , rrjetit elektrik dhe vendosja e hidrosanitarëve te reja dhe hidroizolimit te ri. Po kështu do vepronhet dhe për rikonstruksionin e tualeteve te mësuesve për katin e pare. Do shtohen tualete te reja për çdo kat te vendosura siç janë paraqitur ne vizatime. Duket filluar nga muret e reja qe do behën me tulla te lehtësuara, brezat e betonit mbi muret e reja, sistemi i plote i tubacionit te shkarkimit dhe furnizimit, hidrosanitare dhe Hidroizolimi. Po ashtu do behet dhe një WC për PAK , me gjitha hidrosanitare e përfshira për tualetet për persona me aftësi te kufizuar. Vendodhja e tualetit do përcaktohet gjate punimeve, dhe do behet me doemos ne kat përdhe.

#### Rampa

Ne hyrje te shkollës do vendoset rampa e posaçme për PAK, pendënca maksimale e se cilës do jete 12%. Kujdes te veçante do tregohet ne përzgjedhjen e pllakës se shtrimit te saj qe te ketë koef te fërkimit sipas legjislacionit ne fuqi për aksesueshmërinë e personave me aftësi te kufizuar.

#### Fasada

Ne ketë faze nuk do te kryhen punime ne pjesën e jashtme te godinës, përjashto këtu vendosjen e davançalëve dhe zëvendësimi i tri dritareve te dëmtuara.

#### MNZ

Do behet vetëm shtrimi i tubacioneve siç parashikohet ne preventiv me daljet përkatëses ne gjitha katet e godinës dhe deri tek ambienti i paracaktuar si ambient teknik.

#### Rrjeti i ngrohjes.

Ne ketë faze do behet shtrimi i rrjetit te ngrohjes ne objekt, i cili do shtrohet brenda shtresës niveluese te re qe do vendoset. Ne ketë faze do behet vendosja e rrjetit nga dhoma tekniket deri tek kolektorët , kolektorët , dhe dalja e tubacioneve ne mure. Rrjeti pas vendosje do testohet për rrjedhje te mundshme apo dëmtimet gjate shtrimit te tij. Lidhja e a e kolektorëve me radiatorët do behet me tub multistrat pexb-al-pexb me izolim termik paraprak me spesor 6 mm, me dimensione sipas projektit. Lidhja e kolonave me kolektorët me tub multistrat pexb-al-pexb me dimensione Ø26x3 me izolim termik

paraparak me spesor 9 mm. Tubacionet kryesore nen dysHEME ne katin përdhe dhe kolonat vertikale (brenda murit) me tub prej çeliku te zi te veshur me Izolacion termik armaflex me spesor 9 mm, me dimensione sipas projektit. Ekstremitetet e lira te tubave multistrat te lihen **10 cm jashtë murit dhe te mbyllen me tapa te qëndrueshme** prej materiali plastik ose gome për te ndaluar hyrjen e papastërtive. Vendosja dhe numri i elementeve te vizatuar ka karakter konvencional, pasi vendosja e tyre nuk do te behet ne ketë faze te zbatimit te projektit dhe nuk është e paraqitur as ne preventiv

Punimet e prishjes

Çdo pajisje si dere, llambe, lavaman apo çdo tjetër do hiqet me kujdes pa e dëmtuar dhe do i dorëzohet Autoritetit Kontraktor me procesverbal dhe ne asnjë mënyre nuk duhet te mbahet nga Kontraktuesi.

### **Referenca normative e ligjore.**

Vendimin numër 319 të Këshillit të Ministrave që mban datën 12 prill 2017

Këshilli i Ministrave Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar"

Punoi

LENI-ING